



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Në Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 40 shkronja (h) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që:

Në mbështetje të neneve 12, 14 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 9, 17 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021 dhe nenit 14 të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike 15Nr.011-5823 të datës 01.02.2016, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me datë _____ 2023, të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E MEMORIALIT TË UÇK-së NË ZONËN KADASTRALE QYLAGË

Neni 1

MIRATOHET, Vendimi për vendosjen e memorialit përkujtimor kushtuar luftës së lavdishme të UÇK-së.

Neni 2

Lokacioni për vendosjen e memorialit përkujtimor kushtuar luftës së lavdishme të UÇK-së, shtrihet në pjesën e parcelës kadastrale P-71409090-00479-0 me sipërfaqe prej 2880m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 197887 m² Zona Kadastrale Qylagë në pronësi të Komunës së Lipjanit.

Neni 3

Ky Vendim paraqet bazë për lejin e vendosjes së memorialit përkujtimor kushtuar luftës së lavdishme të UÇK-së në lokacionin e përkthyer në neni 2 të këtij vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Zyra e Kryetarit-Sektori Pronëso- Juridik, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastrë, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij propozim-vendimi është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021 dhe Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike 15Nr.011-5823 të datës 01.02.2016.

Përmes shkresës 1-462/01-16241 të datës 31.03.2023, Këshilli Organizativ për realizimin e projektit Memorial Istikamet e UÇK-së, i është drejtuar Kryetarit të Komunës me kërkesë për ndarjen e një pjese të pronës komunale me sipërfaqe prej 2880 m² nga parcela kadastrale P-71409090-00479-0 ZK Qylagë, me qëllim të ngritjes së Memorialit Istikamet e UÇK-së, kushtuar luftës së lavdishme të UÇK-së.

Bazuar në aktin e datës 08.05.2023 Nr.8-351/01-17252 të Drejtoratit për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, ka lëshuar informacion urban për parcelën kadastrale P-71409090-00479-0 ZK Qylagë e cila është e koncentruar në kuadër të zonës së planifikuar si Zonë pyjore që përfshinë tokën e mbuluar me pemë pyjore në formë të grumbllit pyjor që përfshinë edhe bashkësitë bioekologjike.

Në bashkëpunim me zyrtarët e gjeodezisë, është skicuar lokacioni i propozuar sipas projektit Memoriali Istikamet e UÇK-së, hartuar nga Zyra projektuese "ARCH BASI" SH.P.K, konkretisht në parcelën kadastrale P-71409090-00479-0 me sipërfaqe prej 197887 m² ZK Qylagë në pronësi të Komunës së Lipjanit.

Nga të cekurat më lartë, me qëllim të nderimit të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij propozim-Vendimi.

INr. 363/01-24994
Datë 16.05.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

